



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

REPubLIKA E KOSOVËS REPubLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK		Kaçaniku	
Data	30.01.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-2J03
		Shtojcë	✓

## Raport

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

### Takimet

Me të hyrë në muajin dhjetor, Kryetari i Komunës Besim Ilazi së bashku me ekzekutivin komunal është takuar dhe ka diskutuar formën e përgatitjes së takimit vjetor me qytetar, ku do të diskutohej me qytetarët për punën e tij dhe të Komunës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022. Me të përfunduar takimet e ekzekutivit është vendosur që takimi i fund vitit me qytetar të mbahet me datë:

19.12.2022 (e hënë) në sallën e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, duke filluar nga ora 14:00. Të dhënat i janë përcjell zyrës për informim për publikim.

### **Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike**

-Me 05. 12.2022, është publikuar njoftimi për mbajtjen e takimit publik të Kryetarit Ilazi me qytetar. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebook-un e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php...>

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/12/per-fatlumen.pdf>

Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKaçanik>

Poashtu është vendosur edhe emaili ku është caktuar personi dhe periudha kohore ku qytetarët kanë pasur mundësinë që të përcjellin kërkesat e tyre:

Komentet dhe sygjërimet, mund t'i dërgoni deri me datën 19 dhjetor në ora 16:00. Email: [besim.q.ilazi@rks-gov.net](mailto:besim.q.ilazi@rks-gov.net), [fatlume.selimi@rks-gov.net](mailto:fatlume.selimi@rks-gov.net)

**Komentet:**

Komentet:

1- Fahredin Dema, Nexhmedin Dema- banor të rrugës “ Qamil Ilazi”:

Shprehën shqetësimin e tyre në mos hartimin dhe përfundimin e procedurave të Planit Komunal Zhvillimor si dhe largimin e mbeturinave nga rruga.

2- Ramadan Kuka- Si qëndron Komuna e Kaçanikut me nivelin e cilësisë në arsim?

3- Azem Koraqi- Kovaqec

Disa punë të mira janë kryer, ndërsa do të marrim kërkesat dhe nevojat e banorëve të këtij lokaliteti dhe të njëjtat do ti përcjellim tek komuna për trajtim të mëtejshëm.

4- Fatmir Luta- Ivajë- Mbetet shqetësuese hedhja e mbeturinave ilegale në rrugën “ 24 Marsi”, prioritet me u hap rruga primare.

5- Brahim Dalloshi- Kërkoj që të pastrohen bazenet e ujit të pijes, caktimi i lokacionit për varrezat e fshatit si dhe rregullimi i disa rrugicave.

6- Adnan Krasniqi- Kaçanik i vjetër

Në lagjen “ Qardak” të rregullohen ujërat atmosferike, rregullimi i ndriçimit në rrugën “ Epopeja e UÇK-së, di dhe vendosja e kapakëve të pusëve në disa rrugë.

Përgjigjet:

Pas rmbledhjes si komenteve, kryetari i Komunës së bashku me ekzekutivin komunal ka dhënë këto përgjigje:

1-Plani Zhvillimor Komunal tashmë është përcjellur në ministri si draft i parë, dhe sapo të marrim konfirmimin nga ana e ministrisë do të vazhdojmë më pas me procedurat e tjera siç janë debatet publike e deri tek jetësimi i dokumentit në fjalë.

2- Çdo ditë është duke u bërë punë e pa ndalur në krijimin e kushteve sa më cilësorë për mësim dhënie dhe mësim nxënie, si parakushte për ngritje të cilësisë në arsim, ndërsa tashmë kemi bërë subvencionimin e transportit për nxënësit e shkollës profesionale.

3- Pastrimi i rrugëve sidomos gjatë sezonit dimëror bëhet me prioritet pra tek rrugët kryesore të qytetit dhe nëpër fshatra, ndërsa varësisht prej mundësive vazhdohet nëpër degëzime të rrugëve.

4- Bazenet e ujit të pijes tashmë janë pastruar, ndërsa caktimi i lokacionit do të bëhet në koordinim me vet banorët e këtij lokaliteti, kurse rregullimi i rrugicave bëhet në bazë të kontratës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale, varësisht nga nevoja emergjente për të intervenuar.

5. ujërat atmosferik do të rregullohen në bazë të kontratës “ Rregullimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike, e poashtu pasi të lidhet kontrata për rregullimin e ndriçimit publik do të sanohen problemet dhe defektet e ndriçimit publik edhe në lagjen e lartcekur.

6. Intervenimet në sistemin e ngrohës do të bëhen varësisht nga paraqitja e nevojave emergjente për të intervenuar, ndërsa me planifikimet buxhetore për tri vitet e ardhshme është paraparë edhe rregullimi i sallës sportive në Dubravë. Do të rishikohen mundësitë investive edhe në rregullimin e përroskave dhe urave në këtë pjesë.

Përgatiti:

Fatlume Guri Selimi

Zyrtare Përgjegjëse për Konsultime Publike

